# DËSHMI ARKIVI

**A-457429**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Influencuesja 21-vjeçare u nxor zvarrë nga shtëpia dhe u ekzekutua para syve të babait të saj |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/19/influencuesja-21-vjecare-u-nxor-zvarre-nga-shtepia-dhe-u-ekzekutua-para-syve-te-babait-te-saj/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 10:44:43 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 19 shtator 2026, 10:41:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 19 shtator 2026, 10:40:00 UTC → 19 shtator 2026, 10:42:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e4328f4307407aa6462962fe7f667e09bfc7fec338768d7f665068b6f49d2c1d` |
| TEKSTI | `66006e6e4533794b5afa2f96e9a7e48cdeddd8b45af6ca5edbca235a72f3a260` |
| PAMJA | `5657e5085ff9960093cce1a790a353f8df3944c3f6c1b9d9d52dd5d1a5254b0e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `db372fc5d7cbdbe4c8ff94916ae298f70e7753478e9dffa1a4b9fcf1a29428a0` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a0b332b3aa7ecfa1fb91f9dd35095ec558c07d306f6207fe4bc42429a4dfb028` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/db372fc5d7cbdbe4c8ff94916ae298f70e7753478e9dffa1a4b9fcf1a29428a0`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA TË FUNDIT

# Influencuesja 21-vjeçare u nxor zvarrë nga shtëpia dhe u ekzekutua para syve të babait të saj

19/09/2026 12:41



**Një influencuese 21-vjeçare u nxor me forcë nga banesa e saj dhe u qëllua për vdekje para syve të babait, vetëm pak ditë pasi ishte liruar nga paraburgimi.**

Evelyn Lima Dantas po hetohej nga autoritetet për përfshirje të dyshuar në vrasjen e një ish-polici në verilindje të Brazilit, kur u ekzekutua me armë zjarri në orët e para të së mërkurës.

21-vjeçarja kishte më shumë se 150 mijë ndjekës në rrjetet sociale, ku publikonte video për jetën e përditshme, bukurinë dhe fitnesin.

Sipas dëshmisë së babait të saj, dy persona hynë me forcë në banesën e familjes rreth orës 03:30 të mëngjesit. Ata e nxorën të renë jashtë dhe e qëlluan disa herë për vdekje. Në vendngjarje, autorët shkruan me bojë spraj shkronjat "TCP", akronim që i referohet grupit kriminal Terceiro Comando Puro (Third Pure Command), një prej fraksioneve kriminale të njohura në Brazil.

Dëshmitarët thanë se autorët u larguan me një automjet përpara mbërritjes së policisë. Kur efektivët mbërritën, gjetën trupin e 21-vjeçares në trotuar, të mbuluar me një çarçaf.

Vrasja ndodhi në mes të hetimeve për ekzekutimin e ish-policit Antonio Anildo Alves da Silva, 56 vjeç, i cili ishte qëlluar për vdekje më 29 korrik nga katër persona me fytyra të mbuluara, jashtë një supermarketi.

Hetuesit dyshonin se Dantas kishte ndihmuar autorët e vrasjes së ish-policit dhe ajo ishte arrestuar në korrik. Megjithatë, ajo u lirua përkohësisht më 9 shtator, vetëm rreth një javë para se të vritej.

Sipas policisë, 21-vjeçarja ishte e njohur më herët për autoritetet, pasi ishte arrestuar edhe më parë nën dyshimin për trafik droge në interes të një grupi kriminal.

Policia ka nisur hetimet për vrasjen e saj dhe po punon për identifikimin dhe arrestimin e autorëve. Megjithatë, autoritetet theksuan se ende nuk mund të konfirmojnë nëse grupi i përmendur në mbishkrimin "TCP" ka pasur realisht rol në ekzekutim.

Një nga pistat që po hetohet është se vrasja mund të ketë qenë një akt hakmarrjeje.

*"Po punojmë me hipotezën e një tentative për të mbuluar gjurmët ose të një hakmarrjeje nga ndonjë fraksion kriminal"*, tha Rodrigo Lopes për gazetarët

**Top Channel**

## Bota »







## Kryesore



Krim i rëndë në familje në Tiranë/ 68-vjeçari vret gruan me thikë dhe arratiset nga vendngjarja, reagon policia
12:08

"Prania Besnike", zbardhet mbledhja e djeshme/ Qindra ankesa dhe dëgjesa në të gjithë vendin, Rama: Nuk është ideja thjesht që të marrim e të çojmë halle
08:26

Raporti i prodhuar gabim nga AI gati sa nuk shkaktoi luftë SHBA-Kinë, ushtria amerikane u përgatit të ndalonte anijen kineze
08:01

E papritur/ Ndahet nga jeta në moshën 22-vjeçare influencerja e njohur pak javë pas operacionit për gjoksin
10:07

Kush janë surprizat e Maranit? Një rikthim i madh, dy debutues dhe disa mungesa të bujshme
11:11

## Më të lexuarat

Rruga Milot-Balldren/ 365 mln euro nën hijen e SPAK, në konsorciumin fitues edhe emra në hetim nga Prokuroria e Posaçme

Tragjedi në Itali, 42-vjeçarja shqiptare përplaset për vdekje nga kamioni i mbetjeve, vajza 9-vjeçare pa gjithë skenën

Bordi i Transparencës ndryshon çmimet e karburanteve, nafta dhe benzina pësojnë rënie

Putini troket në derën e Evropës me "mjetin" gjerman të ekstremit të djathtë/ Moska dhe AfD në të njëjtën tryezë për kthimin e gazit rus në Berlin

Video/ U kap mat me gruan e një tjetri, momenti i frikshëm kur burri bie nga dritarja teksa tentoi të arratisej

Foto/ Tragjike në Greqi, si humbën jetën tre të rinjtë shqiptarë, nga aksidenti edhe dy të tjerë të plagosur në gjendje kritike

SHBA dhe Danimarka arrijnë marrëveshje për Groenlandën pas kërcënimeve të Trump për aneksim

Bashkëshortja e Alban Hoxhës humbi jetën pas lindjes së djalit, Gjykata e Lartë rrëzon rekursin e dy mjekëve

5.2 milionë euro dhe një vilë 14 milionëshe/ Ky është Zhigoloja që u akuzua se mashtroi

vejushën e pasur në Manhatan

Krim i rëndë në familje në Tiranë/ 68-vjeçari vret gruan me thikë dhe arratiset nga vendngjarja, reagon policia



"Nuk kam frikë të rikthehem në shkollë"/ Flet mësuesja që u godit me thikë nga nxënësi 13-vjeçar: Dua të di nga i vjen kjo urrejtje ndaj meje

19/09 11:09



Dyshohet se plagosi për vdekje një foshnjë dhe e futi në një qese plehrash, arrestohet 20-vjeçarja

19/09 09:43



"Më kërcënuan se do të më vrisnin nënën"/ Rrëfimi tronditës i artistes ruse pas arratisjes nga vendi: U detyrova që të merrja pjesë në ekzekutimin e...

19/09 09:40



Earl Spencer zbulon detaje të tjera të bujshme: Mbretëresha Elizabeth donte t'i rikthente Dianës titullin...

19/09 09:18



Video/ U kap mat me gruan e një tjetri, momenti i frikshëm kur burri bie nga dritarja teksa tentoi të arratisej

19/09 09:16



Pas 24 orësh, përfundon me sukses operacioni për binjaket e bashkuara në kokë

19/09 08:17

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »




Top Channel/ Maran zgjedh 29 kuqezinjtë, kë riktheu dhe kë la jashtë liste



Top Channel/ Gërmimet e reja në Antigonea, 70-80% e qytetit antik mbetet i pazbuluar nën tokë



Top Channel/ "Super El Niño" mund të sjellë valë të forta të ftohti dhe dëborë në Mesdhe



Top Channel/ Fermerët e Biranjit dhe Lumalasit humbin prodhimin nga goditjet e motit



Top Channel/ Detyra dhe klube deri në orën 15:00, ekspertët ngrenë pikëpyetje për kushtet



Top Channel/ Fshati i Këlcyrës po boshatiset, sfida e nxënësve dhe mësuesve rruga e vështirë



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.